

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës

Në përputhje me autorizimin që është dhënë sipas nenit 17.b të Rregullores së UNMIK-ut 2001/24 të datës 01 Tetor 2001 mbi ndryshimin e Rregullores Nr. 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor 2001 mbi licensimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e Kompanive dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit,

Me qëllim të zbatimit të nenit 28 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25,

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 Mars 2002, miratoi:

Regulli 9 mbi përshkrimin e kërkesave për rezerva të kompanive të sigurimit

Pjesa e dytë Kompanitë e sigurimit Jetësor

Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme

1. Fushëveprimi I këtij rregulli

Ky rregull aplikohet për të gjithë siguresit e autorizuar dhe të licensuar për të udhëhequr bizensin në kategorinë apo kategoritë e sigurimit jetësor të autorizuar sipas Rregullores së Sigurimit.

2. Qëllimet e Rezervave

Qëllimi i mbajtjes së rezervave teknike është përcaktimi i rezervave për detyrime dhe ofrimi i mjeteve të mjaftueshme për të mbuluar përfitimin e polisës sipas kushteve të politikës përkatëse në fuqi në një kompani të sigurimit jetësor. Vlerësimi i rezervës për detyrime të përfitimit të polisës bazohet në supozimin se kompania e sigurimit jetësor është një shqetësim i vazhdueshëm.

3. Rezervat teknike të Obligueshme

Cdo sigurues i sigurimit jetësor kërkohet që të ketë rezerva teknike (kërkesë për rezerva) të përcaktuara dhe të llogaritura në bazë të metodave të përshkruara në këtë rregull.

4. Lloagria e Dopolitimit të Rezervave

Cdo sigurues i sigurimit jetësor duhet që në mënyrë të vazhdueshme të mbajë në depozita para të gatshme apo mjete të përafërta me para të gatshme në shumë prej jo më pak se njëzetepesë (25%) përqind e rezervave teknike të tij në një llogari të rezervave apo llogari me banka apo institucione financiare të aprovuara nga BPK-ja.

Neni 2 Përcaktimi i shumës për Rezerva Teknike (Kërkesat për Rezerva)

1. Përcaktimi aktuariel i detyrimeve nga përfitimi i polisës

Rezervat teknike të kërkuara për një kompani të sigurimit jetësor përcaktohen nga aktuari, të pranueshme nga BPK-ja, deri në datën e vlerësimit për të gjitha kategorië e sigurimit jetësor të shkruara dhe në fuqi nga një kompani e sigurimit jetësor.

2. Metodologjia e kalkulimit të rezervave teknike

Metoda e premisë së polisave

- Metoda e pranueshme e vlerësimit për rezervat teknike për polisa të sigurimit jetësor është metoda e premisë së polisës.

Sipas kësaj metode, benefitet e polisës së sigurimit jetësor, rezervat teknike përbëhen nga dy (2) komponente:

a) Përfitimet e premisë nga detyrimet e skaduara

Përfitimi i polisës nga detyrimet për cdo psgesë të polisës që është si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur para datës së vlerësimit është:

- (i) Vlera prezente e përfitimit deri në datën e vlerësimit, plus
- (ii) Cdo interes i garantuar apo që pritët të vendoset në të; plus
- (iii) Shpenzimet administrative, minus
- (iv) Një pjesë e mbuluar nga risigurimi,

b) Përfitimi i polisës nga detyrimet e paskaduara

Përfitimi i polisës nga detyrimet për cdo psgesë të polisës që është si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur pas datës së vlerësimit përcaktohet sipas metodës së premisë së polisës.

(i) Polisat jo-pjesëmarrëse

Përfitimi i polisës nga detyrimet për një polisë jo-pjesëmarrëse është vlera e tanishme në vlerësimin e A-B, ku:

- A është pagesa e polisës pas datës së vlerësimit; dhe
- B është vlerësimi i premisë së saj, nëse ekziston, që do të paguhet pas datës së vlerësimit.

(ii) Polisat pjesëmarrëse-përfitimi total i polisës

Totali i përfitimit të polisës nga detyrimet për polisat pjesëmarrëse është më e madhja e shumës së përgjithshme të A-së dhe B-së, ku:

A Është përfitimi minimal i polisës nga detyrimet

Përfitimi minimal i polisës nga detyrimet për polisat pjesëmarrëse është detyrimi i përcaktuar nga:

- (1) Metoda sipas 2.b. (i) më lartë (polisat jo-pjesëmarrëse) mirëpo duke injoruar dividendat e mbajtësi të polisës; plus
- (2) Rezervat e bazuara në supozimet e duhura me polisat jo-pjesëmarrëse të krahasueshme që kanë të njëjtën bruto premi dhe pagesa të polisave mirëpo pa dividenda të polisës.

B Është përfitimi bruto i polisës nga detyrimet

Përfitimi bruto i polisës nga detyrimet për polisat pjesëmarrëse është detyrimi i përcaktuar nga:

- (1) Metoda sipas 2.b. (i) më lartë (polisat jo-pjesëmarrëse) duke përfshirë dividendat e mbajtësi të polisës dhe duke përdorur preminë bruto si premi vlerësuese, plus
- (2) Rezervat e bazuara në supozimet e duhura për polisat pjesëmarrëse, minus
- (3) Reduktimet e dividendave të mbajtësve të polisave.

Dividentat e mbajtësve të polisave reduktohen sipas pjesës së dhënë nga X, Ë, dhe Z ku:

- X është fitimi neto i investimeve në një degë pjesëmarrëse përveq atyre të marrura në përcaktimin e përfitimit të mbajtësit të polisës nga detyrimet;
- Ë është e hyra neto nga përfitimi në degët pjesëmarrëse për të cilat nuk është përcaktuar dividendë specifike për mbajtësin e polisës; dhe
- Z Është, “Shumat” në degët tjera.

Neni 3

Parimet dhe udhëzimet për përcaktimin e rezervave teknike për kompani të sigurimit jetësor

1. Vlerësimi Aktuariel

Në kalkulimin e përfitimit të polisës nga detyrimet për një kompani të sigurimit jetësor duhet të aplikohen parimet aktuariele specifike për metodën e premisë së polisës. Përveq kësaj, parimet e përgjithëshme në vijim duhet gjithashtu të lidhen me:

- a) detyrimet aktuariele duhet të llogariten duke pasë parasyshë që ato janë shqetësim i vazhdueshëm duke njohur shkallën e rrezikut të trashëguar nga obligimet.
- b) Detyrimet aktuariele duhet të përfshijnë vetëm një rezervë të limituar dhe të arsyeshme për devijime të pafavorshme.
- c) Të gjitha shpenzimet e përvetësimit, pa limite arbitrare duhet të inkorporohen në llogaritjen e detyrimeve aktuariele dhe kalkulimi bëhet gjatë periudhës së plotë të polisës.
- d) Shpenzimi i cili është factor në kalkulimin e detyrimeve aktuariele përfshinë dividendat e mbajtësit të polisës, përvojën e kthimit të fondeve, shpenzimet në lidhje me to dhe tatimi i drejtpërdrejt (tatimi i premisë).
- e) Privilegjet e fitimit (dorëzimit) dhe pozitat e polisës duhet të llogariten në një mënyrë të ngjashme me përfitime tjera të polisës duke aplikuar

teknika normale aktuarielle duke përfshirë zbritjen për probabilitetin e ngjarjes.

2. Ndryshimet në supozime

Efektet e ndryshimeve në supozimet e vlerësimit duhet të llogariten për sa i përket:

- a) Periudhën e ndryshimit nëse ndryshimi ka efekt vetëm në periudhën finanfiare, apo
- b) Periudhën e ndryshimit nëse ndryshimi ka efekt në rezultatet financiare në të dyja periudhat të tanishme dhe të ardhshme.

3. Metodatat e Pranueshme

Ky rregull përshkruan metodën bazike të kalkulimit të rezervave teknike. Mund të adoptohet përdorimi i metodologjive alternative duke marrë parasysh që ato metoda të bazohen në praktika mbi rezervat të pranuar përgjithësisht dhe të formuluar sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të aprovuara nga BPK-ja.

4. Arovimi nga BPK-ja

Ndryshimet në lidhje me përdorimin e metodologjive të rezervave duhet të bëhen me aprovim paraprak nga BPK-ja dhe të paraqiten në raportin vjetor të Kompanisë së sigurimit.

5. Faktorët nënvizues

Detyrimet aktuarielle duhet të bazohen në të gjithë faktorët nënvizues duke përfshirë devijimet e pafavorshme të supozuara. Sipas kësaj të gjitha përfitimet e ardhshme të polisave dhe shpenzimet, të reduktuar sipas shumës së plotë të premive të ardhshme, duhet të ofrohen në detyrimet aktuarielle.

6. Informatat. Informatat në vijim duhet të paraqiten

- a) Përgjegjësitë e aktuarit të caktuar.
- b) Përbërja e detyrimeve aktuarielle dhe mjetet në lidhje me to të cilat përfshijnë:
 - (i) Detyrimet aktuarielle sipas kategorisë së biznesit, dhe
 - (ii) Llojet e investimeve të cilat përkrahin çdo kategori të biznesit si dhe kapitalin dhe tepicën.

- c) Natyra e detyrimeve aktuariele të cilat tregojnë se:
- (i) detyrimet aktuariele përfaqësojnë shumat të cilat së bashku me të hyrat nga premitë dhe investimet e ardhshme do të jen të mjaftueshme për të paguar përfitimet e ardhshme të parashikuara, përfshirë dividendat e mbajtësve të polisave dhe shpenzimet, dhe
 - (ii) Detyrimet aktuariele përfshijnë shumat shtesë për devijime të pafavorshme nga parashikimet më të mira të supozimeve dhe këto shuma ndryshojnë bazuar në shkallën e psigurisë në supozime, dhe
 - (iii) Shumica e parashikimeve të përdorura në vlerësimet aktuariele kan të bëjnë me ngjarjet të cilat ndodhin shumë vite në të ardhmen dhe I nënshtrohen revidimit në ditë matëse që pasojnë.
- d) Natyra e matjes së pasigurisë së trashëguar në llogaritjen e detyrimeve aktuariele për të përshkruar:
- (i) Faktorët kryesor (dmth. Dëmet dhe përfitimet e ardhëshme të polisave, dividendat e ardhshme, fitimet e ardhshme nga investimet etj) merren parasyshë në llogaritjen e detyrimeve aktuariele si dhe supozimet kryesore te bëra në lidhje me keta factor, dhe
 - (ii) Burimet më të mëdha të të dhënave të përdorura dhe elementet kryesore të metodologjive që aplikohen (dmth tabela e mortalitetit) në arritjen e parashikimeve të mortalitetit, dhe
 - (iii) Mënyra në të cilën masa e pasigurisë lejohet në procesin e vleresimit përfshirë themelimin e margjinës për devijimet e pafavorshme.
- e) ndryshimet në detyrimet aktuariele të cilat do të përfshijnë
- (i) Ato që jan rezultat I ndryshimeve të supozimeve aktuariele dhe ndryshimet në rezervat për devijime të pafavorshme, sipas shkakut kryesor, dhe
 - (ii) Një sqarim për secilin ndryshim të madh
- f) Rezervat negative

- g) Rreziku I kredisë, duke përfshirë, dhe
- (i) rasti në të cilin fitimet e parashikuara nga investimet janë reduktuar
 - (ii) Shumat e cfarëdo reserve shtesë për humbje ciklike të kredise të përfshirë në kalkulimin e detyrimeve aktuariale.
- h) Rreziku I risigurimit duke përfshirë:
- (i) shtrirja në të cilën detyrimet aktuariale janë reduktuar apo rritur si rezultat I risigurimit, dhe
 - (ii) Shuma e ripërtrirë nga risiguresit për dëmet e ndodhura, dhe
 - (iii) Shumat e koncentrimëve të mëdha të risigurimit me cfaredo risiguresi apo grupi risiguresish, dhe
 - (iv) Natyra dhe rëndësia e transaksioneve të risigurimit dhe retrocesionit e future gjat periudhës.
- (i) Rreziqe të tjera përfshirë informatat mbi natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve tjera të mëdha ndaj të cilave kompania është e ekspozuar.

7. Rezerva për devijime të pafavorshme

Në vlerësimin e detyrimeve, duhet të merren parasysh obligimet e siguresit ndaj mbajtësve të polisave dhe të dëmtuarve sikurse dhe variabilitetit të kushteve që kanë efekt në pagesën e dëmëve të ardhshme. Një konsideratë e tillë do të rezultojë në vlerësimin e detyrimeve në baza konzervative.

Neni 4 Hyrja në fuqi

Ky rregull hynë në fuqi me 1 Prill, 2002.

David Wbeatherman
Ushtrues i detyrës së Drejtorit Gjeneral